



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

Zyra e Auditorit Gjeneral/Kancelarija Glavnog Revizora

**AUDITIMI FINANCIAR
KOMUNA E SHTËRPCES
PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN QË PËRFUNDON MË
31 DHJETOR 2007**

Prishtinë, Dhjetor 2008

LETËR DORËZIMI

Datë: 30.12. 2008

Për: Z.Stanko Jakovleviq

I nderuar Z. Jakovleviq,

Ky është raporti ynë final mbi rezultatet e auditimit nga Zyra e Auditorit Gjeneral të pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpces për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007. Në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/33, ky raport do të bëhet publik.

Raporti ynë përmban rekomandimet për veprimet tuaja. Rregullorja 2005/33, Neni 1 B. (e) kërkon që brenda 30 ditëve të publikimit të raportit tonë të auditimit, ju duhet të parashtroni një raport që tregon se si institucioni juaj do të implementoj këto rekomandime.

Rapoti juaj pritet më 30 Janar 2009.

E vlersojmë bashkëpunimin dhe mirësjelljen e ofruar stafit tonë gjatë auditimit. Zyra e Auditorit Gjeneral mirëpret bashkëpunimin me ju në të ardhmen në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008.

Me nderime,

Linda Casella
Auditor Gjeneral

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje e Përgjithshme	5
II. Parathënie	6
III. Statusi i Rekomandimeve të Auditorit nga Vitet e Mëhershme	7
IV. Fushëveprimi i Auditimit	11
V. Mendimi i auditorit	12
VI. Çasja e Auditimit	14
VII. Të Gjeturat Kyqe të Auditimit	16

Shtojcë

- I. Komuna e Shtërpces
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007
- II. Komentet e Menaxhmentit të Komunës

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

AGJ	Auditori Gjeneral
UA	Udhëzimi Administrativ
OE	Operatori Ekonomik
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
SE	Sigurimi i Egzekutimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpces (më tej referuar si “Komuna”) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

Për shkak të çështjeve të diskutuara në Pjesën V: Mendimi i auditorit ne nuk ishim në gjendje të japim dhe ne nuk japim një mendim mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Të gjeturat dhe rekomandimet e ndërlidhura janë paraqitur përbrenda Pjesës VII të raportit. ZAGJ nxit Manaxhmentin e Lartë të Komunës të ndërmarrë veprime korigjuese mbi këto rekomandime dhe para kësaj të paraqesë një Plan Veprimi për shqyrtimin e këtyre rekomandimeve 30 ditë nga pranimi i Raportit Final të Auditimit.

II. PARATHËNIE

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18, datë 4 Tetor 2002, ka themeluar Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) në Kosovë. Sipas Nenit 3.2 të kësaj rregullore, nga Auditori Gjeneral (AG) kërkohet të kryejë auditim për çdo vit të të gjitha institucioneve të Kosovës që të përcaktojë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Nëse shënimet financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- Ndërshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të ndërmarra përbrenda institucioneve apo entiteve të audituara; dhe
- Të gjitha çështjet që dalin ga auditimi ose që ndërlidhen me të.

Në Mars 2003, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 2003/2 “Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” që është miratuar zyrtarisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 12 Maj 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/17. Neni 42 i Ligjit deklaroi se AGJ do të përgatisë dhe t’i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal ku do të parashtrihen opinionet e AGJ mbi atë se nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në financat e organizatave buxhetore në fjalë.

III. STATUSI I REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT NGA VITET E MËHERSHME

Auditimi nga ZAGJ i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006 ka rezultuar në 15 rekomandime. Auditimi aktual përcakton se Komuna nuk ka implementuar ndonjë nga rekomandimet detajet e të cilave janë të paraqitura në tabelën në vazhdim:

Nr	Të gjeturat	Rekomandimi
	Raportimi i të dhënave financiare	
1	Gjatë Auditimit kemi vërejtur se Komuna nuk ka përgatitur Pasqyrat financiare siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 2006/14 Raportimi i Organizatave Buxhetore	ZAGJ rekomandon Menaxhmentin e komunës që të krijoj një sistem të duhur për përgatitjen pasqyrave financiare në pajtim me Udhëzimin Administrativ 2006/14 mbi Raportimin e Organizatave Buxhetore. PF duhet t'i dorëzohen Thesarit më së largu më 31 Janar të vitit vijues.
	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm	
2	Ne kemi vërejtur se Komunës i mungojnë politikat dhe procedurat adekuate që do të shërbenin si udhëzime për një operim sa më efektiv. Të gjitha procedurat rutinore të kryera brenda komunës janë përgatitur në mënyrë manuale dhe nuk mbështeten nga sistemi i teknologjisë informative Po ashtu kemi vërejtur se Komuna nuk e ka të themeluar njësini e auditimit të brendshëm. TI në Komunë është i vendosur në atë mënyrë që i tërë sistemi është i shpërndarë në të gjitha departamentet me baza të veçanta të dhënave të cilat funksionojnë ndaras, pra nuk ekziston sistemi i rrjetit të brendshëm i cili do të mundësonte përdorim më efikas dhe efektiv . Ka mungesë të politikave në formë të shkruar për zhvillim, përdorim dhe planifikim të TI-së.	ZAGJ rekomandon : Menaxhmentin që të : Themeloj sistem funksional të kontroleve të brendshme duke definuar strukturën organizative me ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi. Qe sa më parë të themeloj NJAB duke plotësuar standardet e auditimit të cilat kërkohen në ligjin " Auditimi I Brendshëm"i hyrë në fuqi me 4 korrik 2007. ZAGJ rekomandon: Menaxhmenti të vlerësoj nevojën për sigurinë e TI-së në Komunë dhe të sigurohet që përdorimi i TI-së është i planifikuar në atë mënyrë që të mbështes aktivitetet në Komunë në mënyrë të kënaqshme; Të krijohen strategji dhe politika afatgjatë të zhvillimit të TI-së dhe planifikimit të sigurisë së bazës së të dhënave Të bëhet ndarja efektive e detyrave dhe përgjegjësi
3	Të Hyrat Vetjake Kemi vërejtur se: Përqindja e arkëtimit të tatimit në pronë gjatë vitit 2006 është 15,36%. Me 30.11.2006 janë përgatitur 42 vërejtje për obliguesit e tatimit në pronë në shumë totale prej 104,121.57 €, mirëpo këto nuk u janë dërguar obliguesve tatimor. Nga 13 mostrat e testuara me shumë totale të faturimit për vitin 2006 prej 14,290.87 € janë arkëtuar vetëm 192.78 € e shprehur në përqindje 1,35% . Për më tepër kemi vërejtur se obliguesit tatimor me vendim nr. 5769/1, 4596/2, 2249 dhe 2582 që nga viti 2002 e deri në vitin 2006 nuk kanë paguar obligimet e tatimit në pronë në shumë totale prej 68,261.88 €, d.m.th 65,50 % nga totali i shumës që figuron në vërejtjet e përgatitura për obliguesit e tatimit në pronë. Shërbimi i ofiqarisë gjatë vitit 2006 ka kryer 1480 lëndë. Zyrtarët e ofiqarisë ngarkohen me dëftesa me nr. serik nga depoja e Komunës, mirëpo në disa raste nuk shkruhet nr. rendor i fletëdaljeve nga zyrtari i depos. Komuna ka aplikuar taksën vjetore në objekte afariste në bazë të vendimit nr. 475/24 të dates 06.2006 të lëshuar nga Komuna. Gjatë vitit 2006 janë ngarkuar me këtë taksë 86 subjekte afariste. Nga 8 mostrat e përzgjedhura për ekzaminim, në shumë prej 1,975.00 €	Menaxhmenti duhet të themelojë politikë të brendshme standarde dhe të çartë që do të lehtësonte mbledhjen e tatimit mbi pronën. Bazuar në ligj dhe në rregulloret në fuqi, të merren masa ndaj obliguesve të tatimit në pronë. Komuna duhet po ashtu të vendos procedurat për shpërndarjen e letrave përkujtuese (vërejtjeve) dhe të ndërmerr aktivitete tjera të mbledhjes së tatimit në pronë. Të aplikohen në tërësi Rregulloret për tatimin në pronë. Të mos kryhen shërbime palëve pa arkëtuar edhe taksat e parapara. Të precizohen procedurat e lidhjeve me lëvizjen e mallit nga depoja e Komunes.

Auditimi Financiar
Komuna e Shtërpces për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	<p>janë arkëtuar vetëm 100 €.</p> <p>Gjatë vitit 2006 janë lëshuar 2 leje per ndërtim. Gjatë ekzaminimit të këtyre lëndëve është konstatuar se nuk është respektuar Rregullorja mbi Kushtet e Ndërtimit të Objekteve Ndërtimore nr. 106 e dates 21.02.2002. Dokumentacioni teknik i objektit afarist dhe banesor nuk ka dëshmi se është përpiluar nga personat e licencuar siç është paraparë me Rregulloren nr. 106 neni 2.3.</p> <p>Gjithashtu shfrytëzuesi i objektit nuk posedon lejen përkatëse siç parashihet me Rregulloren nr. 106 neni 5.1.</p> <p>d) Per të hyrat në gjeodezi dhe kadastër nuk dorëzohet raport departamentit per buxhet dhe financa.</p> <p>e) Te të hyrat nga bartja e pronës dhe regjistrimit të hipotekës, kemi bërë testimin e 12 mostrave prej të cilave 3 aplikues me nr. Protokollit 93,148 dhel91/06 nuk kanë paguar taksën e paraparë per këto shërbime.</p>	
	<p>Personeli</p>	
<p>4.</p>	<p>Komuna nuk ka të emëruar zyrtar përgjegjës të personelit.</p> <p>Dosjet e personelit per punëtorët e administrates dhe shëndetësisë ndodhen në zyrën e drejtorit të administrates komunale ndërsa per punëtorët e arsimit në shkolla. Me qëllim testimi kemi përzgjedhur 27 mostra nga 77 punëtor të Departamentit të Administrates. Ku kemi vërejtur se dosjet e personelit janë të kompletuara me përjashtim të një mostre ku në dosje mungon dokumenti identifikues. Tek dosj a e personelit per pozitate emëruara mungon dëshmia mbi zbatimin e procedurave për përshtatshmëri, siç kërkohet me nenin 12 të (LMFP).</p> <p>Në kategorinë e parasë së gatshme kemi vërejtur se kapas blerje me të gatshme (petty cash) per mallrat per të cilat Komuna ka kontraktuar me furnizuesit dhe atë në këto loj blerjesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Furnizim me karburante; - Pagesa e servisimit të automjeteve dhe kompjutereve - Pagesa e gjerave ushqimore. - Pagesa e drekave zyrtare - Pagesa e udhetimeve Zyrtare - Pagesa e provizioneve bankare - Pagesa e mbushjeve telefonike. - Pagesat per punëtorët ose per përfitimin e tyre - Pagesat per ndihma per rastet sociale. - Pagesa e dënimeve në trafik - Pagesa e Faturave që nuk janë lëshuar në emër të Komunës. 	<p>ZAGJ rekomandon: Komunën që të zbatoj Rregulloren Nr. 2001/36 per Shërbimin Civil te Kosovës aktet tjera nënligjore dhe neni 12 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë (LMFPP).</p> <p>Të emërohet zyrtari përgjegjësi personelit i cili duhet në tërësi të zbatoj ligjet dhe rregulloret në fuqi duke kompletuar të gjitha dosjet e të punësuarve dhe që kohë pas kohe të bëjë azhurnimin e dosj eve me ndryshimet eventuale të personelit. Të aplikohen neni 12 i LMFP per pozitat e emëruara Ne gjithashtu rekomandojmë që në departamentin e personelit të përdoret TI me program të përshtatshëm kompjuterik per ruajtjen e dosjeve.</p> <p>ZAGJ rekomandon:</p> <p>Paratë e imëta të menaxhohen dhe shpenzohen në pajtim me Ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e leshuara nga Thesari, siç janë: Ligji nr. 2003/2 Per menaxhimin e financave publike dhe Përgjegjësiive (neni 15.1 dhe 15.2), Rregulla financiare dhe udhëzimet e Thesarit-02 Shpenzimi i Parave Publike(neni 9.3)</p> <p>Rekomandojmë që të mos paguhen nga fondet e parasë publike shpenzimet nevojim: Pagesa per dënimet në trafik (sepse kjo është kundërvajtje dhe duhet të paguhen nga ai vet);</p> <p>Pagesa e Faturave që nuk janë lëshuar në emër të Komunës.</p>
	<p>Mallra dhe Shërbime</p>	
<p>5.</p>	<p>Furnizimi me derivate të naftës Nr. 79/2006</p> <p>këtë kemi vërejtur se kanë ofertua tre operatorë ekonomik (OE), të cilët komisioni i ka vlerësua si të përgjegj shëm përkundër faktit që O.E" Veda Petrol nuk i plotëson kushtet e kërkuara në njoftimin për kontratë pasi nuk ka dorëzua vërtetimin për shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës. Kriter për dhënie të kontratës në njoftimin në gjuhën shqipe si në gazetë ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të Komunës ka qenë çmimi më i ulët ndërsa në gjuhën serbe kriter është çmimi më i ulët dhe lokacioni. Komisioni për vlerësim vendos për dhënie të kontratës OE me çmime më të larta per nga 2 cent per secilin derivat të naftës nën arsyetimin se ky operator është më afër dhe furnizimi do të kryhet me më pak shpenzime. Komisioni per vlerësim të</p>	<p>ZAGJ rekomandon:</p> <p>Komuna në të gjitha rastet para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit ta pergatit Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë per Disponueshmëri të fondeve.</p> <p>Të veprohet në pajtim me nenin 1,10,25.7,30.3,8.2,8.5 dhe nenin 38 të Ligjit per Prokurim Publik 2003/17 i shpallur më Rregulloren e UNMIK-ut 2004/3.</p>

Auditimi Financiar
Komuna e Shtërpces për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	ofertës nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim. Mungesa e deklaratës së nevojave dhe vendosmërisë për disponueshmëri të fondeve.	
	Investimet kapitale	
6.	<p>Riparimi i rrugës Brod-Firajë dhe asfaltimi i rrugës- Golem Potok Nr. 179/2006</p> <p>Njoftimi për kontratë në tabelën e shpalljeve të komunës është bërë me 31.07.06 ndërsa në mjetet e informimit publik me 01.09.06 pastaj me vendim të bordit të drejtorëve të dates 07.09.06 zgjatet afati për paraqitjen e ofertave deri më 22.09.06.</p> <p>Njoftim për dhënie të kontratës me date 05.10.06 po me këtë datë nënshkruhet edhe kontrata në shumën 42,972.00 €. Me vendim të bordit të drejtorëve lejohet shfrytëzimi i mjeteve për aneks kontratë në shumë 7,028.00 € që tejkalon shumën e 10%. Komisioni për vlerësim nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim.</p>	ZAGJ rekomandon: Komunën që zyra e prokurimit aktivitetet e veta ti mbështes në aplikimin e neneve 1, 10, 25.7, 2 4. 3a dhe nenin 34. 2d të Ligjit për Prokurim Publik 2003/17 i shpallur më Rregulloren e UNMIK-ut 2004/3.
7.	<p>Betonimi i oborrit të shkollës "Staja Markoviç" Bitinjë e Epërme Nr. 178/2006</p> <p>Për këtë tender kemi vërejtur se: Tenderin e fiton N.P.N."Liria" i cili nuk i plotëson kushtet e kërkuara në njoftim për kontratë, nuk ka vërtetim për përmbushjen e obligimeve ndaj komunës.</p> <p>Ofertuesi i dytë "Al Trade" nuk ka vërtetim për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së.</p> <p>Komisioni për vlerësim nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim. Data e vlerësimit me datën e nënshkrimit të kontratës janë të njëjta . Mungesa e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve.</p>	ZAGJ rekomandon: Komunën që në çdo aktivitet të prokurimit të veprohet në pajtim me LPP duke përfshirë edhe zbatimin e neneve 1,10,8.2,8.5,25.7 dhe 30.3 të LPP 2003/17.
8.	<p>Furnizim me libra (Lektyra shkollore) Nr. 175/2006</p> <p>Kërkesa për kuotim çmimesh dorëzuar O.E. nuk ka date. Afati kohor për informata shtesë apo informata sqaruese nuk ka date. Nuk precizohet afati për dorëzimin e kuotimit të çmimeve po ashtu edhe data e hapjes së ofertave.</p> <p>Pagesa bëhet para se malli të pranohet. Nga informatat dhe fletë dërgesat mbi pranimin e mallit në shkollë për të cilën janë blerë librat kemi vërtetuar: Me 06.12.06 janë pranuar 870 libra nga 2019 prej tyre ndërsa pjesa tjetër është pranuar me 04.06.2007 përdërisa faturat janë të dates 16.11.06. Mungesa e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve.</p> <p>Komisioni për vlerësim nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim. Nuk respektohet afati tre ditor pas vlerësimit për nënshkrimin e kontratës.</p>	ZAGJ rekomandon; Dosja e tenderit të jetë complete dhe të precizohen afatet kohore. Para se të bëhet pagesa të rishikohet dokumentacioni ashtu siç parashihet me nenin 7.2 të Rregullave financiare dhe udhëzimeve të thesarit 02- Shpenzimi i parave publike dhe të veprimi në pajtim me nenin 1,10 24. 3a dhe 25.7 të LPP 2003/17.
9.	<p>Furnizim me dru për nxehtë Nr. 172/2006</p> <p>Me urdhër obligimin e pagesës (UOP) Nr. 76842 janë paguar 749m X 31 € = 23,219.00 € ndërsa fletë dërgesat (Nr. 17 sasia 230m dhe Nr. 18 sasia 40m) nuk vërtetojnë se është pranuar sasia e paguar me këtë UOP. Mungesa e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve.</p> <p>Komisioni për vlerësim nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim.</p>	ZAGJ rekomandon: Para se të bëhet pagesa të rishikohet dhe kompletohet dokumentacioni ashtu siç parashihet me nenin 7.2 të Rregullave financiare dhe udhëzimeve të thesarit 02-Shpenzimi i parave publike. Të veprohet në pajtim me nenin 1, 8.2, 8.5, 10 dhe 25.7 të LPP 2003/17.
10.	<p>Furnizimi me material teknik(për mrëmbajtjen e shkollave) Nr. 92/2006</p> <p>Në njoftim për kontratë kriter për dhënie të kontratës është parapa çmimi më i ulët dhe lokacioni i ofertesit.</p> <p>Komisioni për vlerësim vendos që fitues të shpallet firma G.P."Standard"nga Shtërpca,që kriterin e kërkuar në njoftim për dhënie të kontratës, atë të afërsisë (lokacionit) e plotëson, ndërsa ka ofertuar me çmime më të larta se ofertuesi tjetër N.T.P."M&K" Ferizaj. Këtë veprim komisioni e arsyeton me një vendim të dates 10.07.06 ku jepen edhe arsyetimet përkatëse.</p> <p>Sa i përket lokacionit, me kontratë parashihet që shpenzimet e transportit i bartë furnizuesi kështu që ky arsyetim nuk qëndron.</p> <p>Shërbimi i shpejtë edhe ky arsyetim nuk qëndron sepse ky nuk është furnizim</p>	ZAGJ rekomandon: Komuna të veproj në pajtim me nenin 1,10,6,8.2,8.5 dhe 25.7 të Ligjit për Prokurim Publik 2003/17 i shpallur më Rregulloren e UNMIK-ut 2004/3. Gjithashtu rekomandojmë që të zbatohet neni 149 i Statutit të Komunës dates 13.02.2004

Auditimi Financiar
Komuna e Shtërpces për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	<p>emergjent. Përmbushja e njërit prej kriterëve për dhënie të kontratës lokacioni dhe mos përmbushja e kriterit tjetër çmimi më i ulët nuk përputhet me kriteret e përcaktuara . Njëri prej personave të autorizuar të këtij operatori ekonomik është anëtar i menaxhmentit të lartë të komunës. Mungesa e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve.</p>	
11.	<p>Furnizim me barna Nr. 109/2006 Për furnizimin prej 1,999.45€ është krye zotimi me kohë, ndërsa për furnizimet tjera nga kjo kontratë zotimi i mjeteve është bërë pas furnizimit. Mungesa e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve. Komisioni për vlerësim nuk ka të nënshkruar deklaratën nën betim.</p>	<p>ZAGJ rekomandon: Menaxhmentin e Komunës që të veprojë në pajtim me nenin 1,10,8.2,8.5 dhe 25.7 të LPP 2003/17.</p>
12.	<p>Ujës-jellësi në Jazhincë CPO Nr. 23060293 Tenderin e ka udhëhequr Mercy Coq's-i që ka investuar në këtë projekt shumë prej 26,000.00€ ndërsa komuna merr pjesë me shumë 15,265.526. Kemi vërejtur Mungesën e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmëri të fondeve për pjesën që investon komuna. Nuk janë përlogaritur penalet për 12 ditë vonësë 15,265.52 x 0,50%=915.93€.</p>	<p>ZAGJ rekomandon: Komunën që në rast të mos respektimit të afatit të përfundimit të punëve nga ana e Operatorit Ekonomik të aplikohen penalet siç parashihet me kontratën e lidhur me atë Operator dhe të veprojë në pajtim me nenin 8.2,8.5 të LPP 2003/17.</p>
13.	<p>Ndërtimi i shkollës në Viqë CPO 56749 Prokurimin e ka udhëhequr Mercy Corps-i me investim në këtë projekt në shumë prej 49,790.75€ ndërsa komuna merr pjesë me shumë prej 15,000.00€. Kontrata është nënshkruar me 14.12.06, raporti për përfundimin e punëve me 19.12.06 ndërsa aneksi për kontributin e komunitetit që do të jep gjatë punimeve është nënshkruar me datë 18.12.06.</p>	<p>ZAGJ rekomandon: Të mos kryhet asnjë veprim i operatorëve ekonomik pa u nënshkruar kontrata. Gjithashtu të respektohet nenin 24 të LPP 2003/17.</p>
14.	<p>Mungesa e raportit vjetor mbi kontratat e përfunduara gjatë vitit 2006. Komuna nuk ka përgatitur një raport, ku do të cekeshin të gjitha kontratat e përfunduara gjatë vitit 2006 në bazë të vlerës së tyre siç janë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrata me vlera minimale 2. Kontrata me vlera të vogla 3. Kontrata me vlera të mesme si dhe 4. Kontrata me vlera të mëdha 	<p>ZAGJ rekomandon: Komunës që të veprohet në përputhje me nenin 5 të Rregullave mbi procedurat e prokurimit publik.</p>
	<p>Menaxhimi i pasurive</p>	
15.	<p>Për pasuritë në Komunë kemi vërejtur se nuk është bërë regjistrimi i pasurisë si dhe i gjithë inventari nuk ka bar-kodet e vendosura. Nuk është bërë regjistrimi me kohë i pasurisë. Nuk dihet vlera e pasurisë së trashëguar si dhe nuk dihet as vlera totale që disponon Komuna pasi që në regjistrat e saj nuk figurojnë vlera e inventarit. Regjistrimi i Pasurive është bërë vetëm për objektin dhe inventarin ku është e vendosur Administrata Komunale dhe jo për pasuritë tjera siç janë; pasuritë e patundshme të Komunës, objektet shkollore, objektet shëndetësore dhe inventarët e tyre. Kemi vërejtur se vozitësit e veturave nuk janë të përgjigjshëm në regjistrimin e kilometrave të kaluara. Në mostrën e zgjedhur për veturat Ford Mondeo 485-KS-387 dhe LadaNiva 301-KS-895 nuk plotësohen si duhet fletudhëtimet për shfrytëzimin e veturës, e në raste tjera nuk plotësohet fare fletudhëtimi për këto dy vetura. Vetura e Komunës Ford Mondeo me targa 485-KS-387 është përdorur në vazhdimësi për udhëtime jashtë Kosovës pa ndonjë arsytim. Në periudhën prej datës 19.04 deri më 31.10.2006 ka kaluar 19072 Kilometra, shumica prej të cilave jashtë vendit. Vetëm në muajin tetor 2006 kjo veturë ka kaluar 2256 km jashtë Kosovës (destinacioni Beograd, Nish, Koqur, Rashkë).</p>	<p>ZAGJ rekomandon: Menaxhmentin e Komunës që të zbatojë Udhëzimin Administrativ 2005/11 -Menaxhimi dhe Regjistrimi i pasurive Qeveritare duke bërë : regjistrimin e të gjitha pasurive me të cilat disponon Komuna; -mjetet themelore duhet të mirëmbahen të regjistruara në regjistrin e mjeteve duke përfshirë edhe lokacionin se ku gjendet mjeti; të zbatohen procedurat për shfrytëzimin e automjeteve dhe mos të lejohet që shfrytëzuesit e veturave të paraqesin gjendje jo reale të kilometrave; të regjistrohen kilometrat e kaluara për të gjitha veturat pa përjashtime; -të krijohen kartela specifike për secilin mjet në mënyrë të veçantë me të gjitha shënimet përkatëse për identifikimin e mjetit jetën e përdorimit, normën e zhvlerësimit, koston e përvetësimit, sasinë e tyre etj.</p>

	Disa prej automjeteve në Komunë nuk janë të regjistruara dhe nuk janë në gjendje të rregullt edhe pse janë shpenzuar 8,305 € për riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.	
--	---	--

IV. FUSHVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka udhëhequr auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpces për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007. Komuna punon nën rregulloren e vetëqeverisjes së Komunave në Kosovë 2000/45, rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/54,2007/30 dhe statutin e Komunës.

Qëllimi kryesor i auditimit është që t'ia mundësojë ZAGJ dhënien e mendimit nëse pasqyrat financiare të Komunës, të paraqitura në Shtojcën I, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, si dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Komtabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi “ Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) është përgjegjës për nxjerrjen e SNKSP. Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare dhe shënimeve përcjellëse në Shtojcën I janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës.

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 është bërë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar mbi Standardet e Auditimit dhe Sigurimit. Bordi funksionon si organ për vendosjen e standardeve ndërkombëtare nën rrethanat e FNK. SNK themelojnë kornizën ndërkombëtare brenda të cilës ZAGJ performon punën e saj dhe mbulon çështjet si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimet e rrezikut dhe përgjigjet në rreziqet e vlersuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punët e tjerve, dhe konkluzionet e auditimit dhe raportimi.

V. MENDIMI I AUDITORIT

Bazat për mohimin e dhënies së mendimit

Përmbledhja e çështjeve të rëndësishme të identifikuara përgjatë procedurave tona të auditimit që na shpjen deri te mohimi i dhënies së mendimit tonë të auditorit janë paraqitur më tej në këtë pjesë. Të gjeturat dhe rekomandimet tona janë shqyrtuar në detaje në Pjesën VII: Të gjeturat kyçe të auditimit dhe rekomandimet.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

3. Pasqyrat Financiare të Komunës të paraqitura në Shtojcë të këtij raporti janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi përshtatshmërinë e informacioneve financiare të paraqitura në pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
2. Shumat e të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 siq janë raportuar në pasqyrat financiare nuk janë të barazuara më të dhënt e ndërlidhura nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e të hyrave dhe shpenzimeve të komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
3. Komuna nuk mban regjistër ndaras për asetet e saj fikse. Veç kësaj nuk ka dëshmi të kryerjes së verifikimit të egzistimit fizik të aseteve më 31 Dhjetor 2007 dhe nuk është bërë barazimi e librave të komunës me numërimin fizik. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë vetëveten mbi plotësinë dhe saktësinë e të dhënave financiare të komunës për asetet fikse.

B. Dizajni dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme

4. Duke u bazuar në rezultatet e procedurave të auditimit ne gjetëm të meta materiale në dizajnin dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës veqanërisht sa i përket mungesës së procesit të përshtatshëm të autorizimit për shpenzimet për derivate të automjeteve, riparimeve dhe mirëmbajtjes. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi vlefshmërinë e këtyre shpenzimeve të njohura në pasqyrat financiare të komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
5. Veç kësaj në lidhje me monitorimin e inkasimit të të hyrave nga lëshimi i certifikatave të ndërtimit ne gjetëm disa raste ku këto licensa janë lëshuar pa dëshmi për inkasimin e të hyrave.
6. Për më tepër komuna nuk ka vendosur dhe nuk operon funksioni i auditimit të brendshëm që është një rast i mospajtueshmërisë me rregulloret përkatëse.

C. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

7. Rastet në vazhdim të mospajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat janë shqyrtuar në tërësi në Pjesën VII: Të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet, janë konsideruar të jenë të një rëndësie të veçantë:
- mos lejimi i pagesës me para në dorë për disa shpenzime
 - procedura tenderuese për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve që bëhen jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret,
 - ndryshime ndërmjet ndërmjet mallrave dhe shërbimeve të kontraktuara dhe atyre që në të vërtetë blihen në terme të çmimit dhe sasis,
 - mos egzistimi i informacionit relevant që kërkohet nga rregullorja siq është raporti i kontratave sipas vlerës së tyre, plani për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe dosje personale të të punësuarve që janë të mangëta.

Duke marrë parasysh të mësipërmet, veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen dhe prandaj ka një risk të gjobave dhe dënimeve shtesë që mund të ngarkohen kundër komunës. Në datën e lëshimit të këtij raporti rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme dhe nuk ka pasur shpalosje adekuate për detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Mohimi i mendimit

Për shkak të egzistencës së pasigurive të shumta materiale dhe për shkak të rëndësisë së çështjeve të shqyrtuara në paragrafët paraprakë, ne nuk ishim në gjendje dhe nuk shprehim mendim mbi pasqyrat financiare të Komunës në pajtueshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar nën Bazën e Kontabilitetit të Parasë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

VI. ÇASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të lëshuara nga Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS). Bordi funksionon si një organ përcaktues i standardeve ndërkombëtare nën patronazhin e FNK. SNA vendosin kornizën punuese ndërkombëtare përbrenda së cilës ZAGJ kryen punën e saj dhe mbulon çështjet siq janë parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlersuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve, si dhe konkluzionet dhe raportimet e auditimit.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtueshmëri me SNKSP-të “Raportimi financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të zgjedhjes së mostrave sipas gjykimit dhe rastit, në zgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Të gjetura dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e shpjegimet tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë egzistuar, të cilat nuk na janë ofruar neve, dhe po të na ishin ofruar, mund të kishin ndryshuar të gjeturat.

Për sa i përket mendimit të auditorit të ZAGJ lidhur me pasqyrat financiare të Komunës, SNA definojnë kriteret specifike që përcaktojnë llojin e opinionit që mund të ipet. Mendimi i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i mendimit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një mendim të pakualifikuar kur egziston cilado nga rrethanat vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ efekti i çështjeve është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara në (a) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mohimin e mendimit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mendim të kundërt.

Një mendim i kualifikuar në përgjithësi shprehet kur ZAGJ konstaton se nuk mund të ipet një mendim i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin, ose kufizimi i fushëveprimit nuk është material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një mendimi të kundërt ose mohim të mendimit.

Mohimi i mendimit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimish nuk mund të shpreh një mendim lidhur me pasqyrat financiare.

Një mendim i kundërt do të ipet kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar dhe jo të plotë të pasqyrave financiare.

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYQE TË AUDITIMIT

Në vazhdim janë të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet që kanë rezultuar nga auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës. Komentet e menaxhmentit në lidhje me secilën të gjetur dhe rekomandim janë në vazhdim të secilës pjesë së bashku me vlersimin tonë të komenteve të menaxhmentit. Komentet e menaxhmentit do të përfshihen në tërësi në Shtojcën 2.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Të gjeturat # 1

Pasqyrat financiare të Komunës të paraqitura në shtojcë të këtij raporti janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Neni 41: Raportimi final i buxhetit nga Ligji mbi menaxhmentin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 2003/2, përshkruan saktësisht formatin dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të komunës.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë Menaxhmentit të Komunës implementimin e plotë të dispozitave përkatëse në lidhje me përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të saj.

Të gjeturat # 2

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne identifikuar ndryshime ndërmjet raportit të të hyrave të komunës dhe atyre që janë marrë nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në shumën EUR 1,871. Veç kësaj, ne gjithashtu identifikuar ndryshime ndërmjet raportit të shpenzimeve të komunës dhe raportit të të hyrave të realizuara nga Departamenti i Urbanizmit në shumën 285 Euro.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të bëjë barazim të shpeshtë të të dhënave të tyre financiare me ato nga institucionet relevante, siq është Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Kjo do të sigurojë korigjime të bëra me kohë të gabimeve të mundshme në gjetjen dhe procesimin e transaksioneve relevante financiare ashtu sikurse edhe informacion financiar të saktë për përdoruesit e raporteve financiare të komunës.

Të gjeturat # 3

Komuna nuk mban regjistër ndaras të aseteve të saj fikse. Veç kësaj nuk ka dëshmi të kryerjes së verifikimit të egzistimit fizik të aseteve më 31 Dhjetor 2007 dhe nuk është bërë barazim i librave të komunës me numërimin fizik.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të dizajnojë dhe implementojë procedura adekuate që do të kërkonin:

- Regjistrime pronësore të detajuara për secilin asset fiks
- Caktimin dhe vënien e numrit identifikues pronësor për secilin asset.
- Politikën e Kapitalizimit nën të cilën pagesat më të vogla se një shumë specifikuar në Euro do të paraqiteshin si shpenzim.

Për më tepër dhe si minimale, libri i pronës duhet të përmbajë informatat në vazhdim për secilin asset fiks:

- Datën e përvetësimit
- Vendndodhjen
- Numrin e vënë nga komuna (numri etiketues)
- Numri serik
- Përshkrimi dhe funksioni
- Baza e kostos
- Detaje të zhvlersimit, përfshirë metodat e llogaritjes për qëllime tatimi dhe raportimi financiar
- Koha e parashikuar e përdorimit
- Kostoja e mirëmbajtjes pas datës së blerjes
- Data e heqjes
- Burimi financues
- Numri referues i dëftesës së shpenzimit (CPO #).

Përveq kësaj në mënyrë që të ofrojë mbrojtje adekuate të aseteve të saj, menaxhmenti i komunës duhet të kryejë verifikim fizik të rregullt, së paku në baza vjetore, të të gjithë artikujve të pronës. Regjistrimet e ndërlidhura të kontabilitetit duhet të barazohen me rezultatet e këtyre numërimeve fizike.

B. Dizajni dhe efektiviteti operativ i kontroleve të brendshme

Të gjeturat # 4

Duke u bazuar në inspektimin tonë të shpenzimeve të caktuara në lidhje me shpenzimin e derivative të automjeteve, ne kemi gjetur se komuna ka mungesë të madhe të implementimit të proceseve të duhura të autorizimit. Dokumentet burimore subjekte të inspektimit tonë nuk kanë pasur dëshmi të aprovimit për pranueshmërinë e tyre nga personi i caktuar për autorizim.

Të gjeturat # 5

Veç kësaj nga inspektimi i procesit të inkasimit të të hyrave ne gjetëm se licensat e ndërtimit nr. 231 dhe 232 për ndërtimin e shkollës në Sevce dhe Brod janë lëshuar pa inkasuar tarifën gjegjëse.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të implementojë saktësisht autorizimin e të gjithë dokumenteve burimore në lidhje me transaksionet financiare duke caktuar personat e duhur dhe duke plotësuar kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave.

Veç kësaj, duhet të implementohen procedurat e duhura të monitorimit të cilat do të siguronin kontroll të duhur mbi procesin e inkasimit të të hyrave.

Të gjeturat # 6

Komuna nuk ka planifikuar dhe implementuar funksione të auditimit të brendshëm. Gjithashtu kjo kërkohet nga rregulloret që janë në fuqi aktualisht.

Rekomandimi

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur përbrenda komunës, funksioni i së cilit është të rishikojë operacionet e kontabilitetit, financiare dhe të tjera. Objektivi kryesor është që t'i ofrojë menaxhmentit informacion në lidhje me efektivitetin e politikave dhe kontrolleve të vendosura. Në rrjedhën e mbledhjes së informacioneve të tilla, auditori i brendshëm vleron saktësinë e të dhënave kontabël dhe të tjera dhe ndihmon në parandalimin e keqpërdorimit të aseteve dhe riskun e gabimeve dhe mashtrimeve të qëllimshme.

C. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

Të gjeturat # 7

Nga inspektimi i pagesave të bëra për furnizimin me disa mallra dhe shërbime gjatë vitit 2007 ne gjetëm disa furnizime siq është për mirëmbajtjen e automjeteve, servisimin e kompjuterrëve, ushqim, udhëtime punë, gjoba të trafikut që janë paguar me para në dorë. Dispozita ligjore gjegjëse nuk lejon pagesa me para në dorë për shpenzime të cilat mund të kryhen në mënyrë praktike përmes procedurave prokuruese, pastaj pagesat për udhëtimet e punës dhe shpenzimet e konferencave si dhe pagesat për gjobat e trafikut.

Rekomandimi

Duke i'u referuar çështjeve të mësipërme të pagesave me para në dorë ne i rekomandojmë menaxhmentit që saktësisht të aplikojë dispozitat në vazhdim:
- Neni 15.1 dhe 15.2 nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 2003/2, dhe
- Neni 9.3 nga Rregulloret Financaire dhe Instruksionet e Thesarit- Shpenzimi i Parasë Publike 02/2006.

Të gjeturat # 8

Nga inspektimi i dokumenteve burimore të lidhura me procedurat tenderuese për ndërtimin e rrugës G. Bitinja – Sushicë ne gjetëm disa parregullsi si: Shpallja është bërë më 19.10.2007 ndërsa hapja e tenderëve më 22.10.2007, vetëm 3 ditë pas, kështu që koha e duhur për dorëzimin e tenderëve nuk është respektuar;

Komisioni vlersues nuk ka marrë në konsideratë ndonjë nga ofertat dhe ka vazhduar me procedurën duke ndjekur rendin e dhënë nga Shefi Ekzekutiv i Zyrës së Prokurimit;
Nuk ka pasur shpallje të kompanisë fituese dhe marrëveshja e prokurimit është nënshkruar një ditë pas hapjes së ofertave;
Dosja nuk përmban vendim për themelimin e komisionit vlersues si dhe dëshmi të së paku 3 ofertave.

Të gjeturat # 9

Dosjet e tenderit për prokurimin e druve për nxehje për nevojat e shkollës si dhe për punët ndërtimore të rrugës Verbestice nuk përfshijnë vendimet për komisioni vlersues.

Veç kësaj tenderi për punë ndërtimore nuk përfshinë dëshmi mbi kompaninë fituese si dhe dëshminë për së paku 3 oferta.

Të gjeturat # 10

Nga inspektimi i dëshmive burimore në lidhje me vazhdimin e kontratës me NTP Abetare për blerjen e paisjeve kompjuterike ne gjetëm se kushtet e kontratës nuk janë ndjekur saktësisht. Çmimet për disa artikuj siq janë paraqitur në faturën shoqëruese janë më të lartë se ato të kontraktuara. Veç kësaj ka artikuj të faturuar të cilët nuk janë paraqitur në specifikacionin e kontratës, siq janë:

Fatura Nr. 236 – artikulli Flash memorie 2GB me çmim EUR 45 nuk është përfshirë në specifikacionin e kontratës,

Fatura Nr. 000115 – artikulli Toner 1100 me çmim EUR 75 kurse sipas kontratës është 51.50 Euro, artikulli letër A4 ku sipas faturës çmimi është EUR 4.20 kurse sipas kontratës EUR 4.05, artikulli toner lbp2900 me çmim EUR 70 nuk është i përfshirë në specifikacionin e kontratës, artikulli flash memorie 4 GB me çmim EUR 62 nuk është përfshirë në specifikacionin e kontratës.

Fatura nr.000175 – artikulli telefon faks me çmim EUR 258 nuk është përfshirë në specifikacionin e kontratës,

Fatura Nr.000174 – artikulli letër A4 me çmim EUR 4,20, sipas kontratës EUR 4.05.

Fatura Nr.000174 – artikulli telefon faks me çmim EUR 252 nuk është përfshirë në specifikacionin e kontratës.

Të gjeturat # 11

Nga inspektimi i dëshmive burimore në lidhje me vazhdimin e kontratës me datë 11.07.2007 me NTP GP Standard për furnizimin me material teknik për mirëmbajtjen e shkollave ne gjetëm se kushtet e kontratës nuk janë ndjekur saktësisht. Çmimet për disa artikuj siq janë paraqitur në faturën e furnizuesit janë të ndrsyhme nga ato të kontraktuara. Për më tepër ka artikuj të faturuar të cilët nuk janë paraqitur në specifikacionin e kontratës, siq janë:

Fatura Nr. 16/07 datë 16.07.2007 – artikulli dorëza për dyer me çmim EUR 3.69 kurse sipas çmimit të kontraktuar është EUR 3.10; artikulli pastrues EUR 1.37 kurse sipas kontratës 0.70 Euro;
Fatura Nr. 15/07 datë 05.05.2007 – artikulli vacuum glass 77X 110 me çmim EUR 26.26 dhe artikulli vacuum glass 56x120 me çmim EUR 17.68 nuk janë në specifikacionin e kontratës.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë menaxhmentit që saktësisht të ndjekë kushtet e kontraktuara për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve.

Për më tepër të gjitha prokurimet duhet të procesohen në pajtueshmëri me dispozitat e dhëna në Ligjin për Prokurimin Publik nr. 2003/17 të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 dhe 2007/20.

Veç kësaj procedura të dhura monitoruese duhet të vendosën dhe implementohen ashtu që të parandalohen parregullsitë dhe keqpërdorimet e fondeve publike.

Të gjeturat # 12

Komuna nuk ka përgatitur një raport të kontratave të kompletura gjatë viti 2007 ta ranguar në bazë të vlerës së tyre (vlera të vogla, të mesme dhe të mëdha) dhe në pajtueshmëri me nenin 5 nga Rregulloret mbi Procedurat e Prokurimit.

Veç kësaj ne nuk gjetëm dëshmi që menaxhmenti i komunës ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjensinë e Prokurimit Publik (APP) planin final të prokurimit për vitin 2007.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të përmbushë ligjet dhe rregulloret përkatëse në lidhje me përgatitjen e raporteve dhe buxheteve të kërkuara.

Të gjeturat # 13

Nga inspektimi i 17 dosjeve personale të të punësuarve nga gjithsej 81 të punësuar në departamentin e Shëndetsisë dhe Administratës ne gjetëm mangësi ne terme të mungesës së shpalljes për vendin e punës dhe dokumentacionit mbështetës për kualifikimin dhe vlersimin vjetor. Dy nga dosjet e kërkuara nuk na janë paraqitur.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të kompletojë dosjet personale me informacionet që mungojnë siq është paraqitur në të gjeturat më lartë ashtu që të përmbushë kërkesat rregullative në lidhje me burimet njerzore.

Shtojcë I

Komuna e Shtërpces

Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor
2007.

TROSKOVI - FISKALNE GODINE 2007

GRANT
Izvor finansiranja10

URBANIZAM
Plata I ostalo

ekonomki Kod 011000

Alocirani fond		Troškovi plate I ostalo								Bilanci (Saldo) 2-4+10	Data Zotimit/Page sës
Datum	Suma	za Mesec	Iznos 5+6	Taksa në pens. Punëdhënës i	Bruto plata	Taksa në pens. Punëmarrës i	Porez	Neto plata 6-7-8	Të kthyerë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12	
	6,612.00	1	1,485.75	70.75	1,415.00	70.75	40.63	1,303.62	0.00	5,126.25	
	0	2	1,485.75	70.75	1,415.00	70.75	40.63	1,303.62	0.00	3,640.50	
	0	3	1,485.75	70.75	1,415.00	70.75	40.63	1,303.62	0.00	2,154.75	
	0.00	4	1,332.45	63.45	1,269.00	63.45	37.69	1,167.86	0.00	822.30	
	0.00	5	1,332.45	63.45	1,269.00	63.45	37.69	1,167.86	0.00	-510.15	
	5,274.00	6	1,024.80	48.80	976.00	48.80	26.35	900.85	0.00	3,739.05	
	0.00	7	1,203.13	57.29	1,145.84	57.29	30.42	1,058.13	0.00	2,535.92	
	0.00	8	1,229.55	58.55	1,171.00	58.55	31.61	1,080.84	0.00	1,306.37	
	1,485.15	9	1,537.20	73.20	1,464.00	73.20	42.95	1,347.85	0.00	1,254.32	
	1,485.15	9.1	136.50	6.50	130.00	6.50	2.18	121.32	0.00	2,602.97	
	1,485.15	10	1,537.20	73.20	1,464.00	73.20	42.95	1,347.85	0.00	2,550.92	
	1,369.88	11	1,297.80	61.80	1,236.00	61.80	36.12	1,138.08	0.00	2,623.00	
		12	1,444.53	68.79	1,375.74	68.79	38.76	1,268.19	0.00	1,178.47	
		12.1	255.15	12.15	243.00	12.15	3.55	227.30	0.00	923.32	
Total	17,711.33	12 MESECI	16,788.01	799.43	15,988.58	799.43	452.16	14,736.99	0.00	923.32	

-17,711.33

GRANT 10
Izvor fin.

Opština 65510
Robe I usluge

Ekonomski kod 013200

Alocirani fond		CPO - Komunalne usluge					Br. CPO-a	Bilans (Saldo)	Opomena
Datum	Suma	Opis	Datum	Obaveza	Troseno	Ek. Kod			
	600.00	Kancelarijski materijal			325.45	13610	23070028	274.55	
	600.00	Troškovi telefona			100	13320	23070137	774.55	
		Kancelarijski materijal			183.43	13610	23070220	591.12	
		Kancelarijski materijal			24.95	14040	23070221	566.17	
		Sevis Kompjutera			110	13509	23070221	456.17	
		Kancelarijski materijal			374.9	13610	23070297	81.27	

		Sevis Kompjutera		81.27	14040	23070309	0.00	
Total:	1,200.00		0.00	1,200.00			0.00	
				1,200.00				

0.00

Izvor finansiranja10

Plata I ostalo

ekonomki Kod 011000

Alocirani fond		Troskovi plate I ostalo								Bilanci (Saldo) 2-4+10	Data Zotimit/P agesës
Datum	Suma	za Mesec	Iznos 5+6	Taksa në pens. Punëdhënës i	Bruto plata	Taksa në pens. Punëmarrës i	Porez	Neto plata 6-7-8	Të kthyerë		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12	
	1,076.25	1	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	2	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	3	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	4	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	5	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	6	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	7	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	8	1,076.25	51.25	1,025.00	51.25	30.11	943.64	0.00	0.00	
	1,076.25	9	836.85	39.85	797.00	39.85	23.28	733.87	0.00	239.40	
	1,076.25	10	836.85	39.85	797.00	39.85	23.28	733.87	0.00	478.80	
	1,076.25	11	836.85	39.85	797.00	39.85	23.28	733.87	0.00	718.20	
	991.01	11.1	153.30	7.30	146.00	7.30	0.00	138.70	0.00	1,555.91	
		12	836.85	39.85	797.00	39.85	23.28	733.87	0.00	719.06	
Total	12,829.76	12 MESECI	12,110.70	581.70	11,540.00	449.85	264.16	8,282.99	0.00	719.06	

GRANT 10

Opstina 65510

Izvor fin.

Robe I usluge

Ekonomski kod 013200

Alocirani fond		CPO - Robe I usluge					Br. CPO-a	Bilans (Saldo)	Opomena
Datum	Suma	Opis	Datum	Obaveza	Troseno	Ek. Kod			
	400	Kancelarijski materijal			461.84	13610	2307075	-61.84	
	300	Servisiranje infor.tehnol.			61.00	14040	23070090	177.16	
	400.00	Kancelarijski materijal			231.78	13610	23070119	345.38	
	400.00	Poslovni rucak			28.00	14310	23070139	717.38	
		Kancelarijski materijal			301.19	13610	23070222	416.19	
		Kancelarijski materijal			255.00	13610	23070287	161.19	
		Servisiranje infor.tehnol.			61.00	14040	23070307	100.19	
		Troskovi telefona			100.00	13320	23070223	0.19	
Total:	1,500.00			0.00	1,499.81			0.19	

1,499.81

0.00

Mallrat dhe Shërbimet/ADM	99,915.00	22,573.00	77,342.00	99,915.00
Komunalite	58,000.00	58,000.00	0.00	58,000.00
Inv. Kap	222,242.00	222,242.00	0.00	222,242.00
Total buxheti (65510)	380,157.00	302,815.00	77,342.00	380,157.00

TROSKOVI - FISKALNE GODINE 2007

GRANT

Izvor finansiranja10

Kancelarija Presednika

Plata I ostalo

ekonomki Kod 011000

Alocirani fond		Troskovi plate I ostalo								Bilanci (Saldo) 2-4+10	Data Zotimit/P agesës
Datum	Suma	za Mesec	Iznos 5+6	Taksa në pens. Punëdhënës i	Bruto plata	Taksa në pens. Punëmarrës i	Porez	Neto plata 6-7-8	Të kthyera		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12	
	41,277.46	1	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	38,161.06	
	13,396.30	2	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	48,440.96	
		3	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	45,324.56	
		I	1,186.50	56.50	1,130.00	56.50	108.36	965.14	0.00	44,138.06	I/"07.
		II	1,307.25	62.25	1,245.00	62.25	118.84	1,063.91	0.00	42,830.81	II/"07.
		4	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	39,714.41	
		5	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	36,598.01	
		6	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	33,481.61	
		III	189.00	9.00	180.00	9.00	0.00	171.00	0.00	33,292.61	
		IV	1,480.50	70.50	1,410.00	70.50	42.64	1,296.86	0.00	31,812.11	
		V	2,556.75	121.75	2,435.00	121.75	130.53	2,182.72	0.00	29,255.36	
		VI	1,065.75	50.75	1,015.00	50.75	25.89	938.36	0.00	28,189.61	
		VII	462.53	22.03	440.50	22.03	54.25	364.23	0.00	27,727.09	
		7	3,116.40	148.40	2,968.00	148.40	282.50	2,537.10	0.00	24,610.69	
		8	3,134.25	148.40	2,985.85	148.40	282.50	2,537.10	0.00	21,476.44	
		8.1	76.65	3.65	73.00	3.65	0.00	69.35	0.00	21,399.79	
		9	3,134.25	149.25	2,985.00	149.25	283.30	2,552.45	0.00	18,265.54	
		10	3,134.25	149.25	2,985.00	149.25	283.30	2,552.45	0.00	15,131.29	
		11	3,134.25	149.25	2,985.00	149.25	283.30	2,552.45	0.00	11,997.04	
		12	3,134.25	149.25	2,985.00	149.25	283.30	2,552.45	0.00	8,862.78	
		VIII	1,281.00	61.00	1,220.00	61.00	41.88	1,117.12	0.00	7,581.78	
		IX	1,464.75	69.75	1,395.00	69.75	138.25	1,187.00	0.00	6,117.03	

		X	1,485.75	70.75	1,415.00	70.75	39.90	1,304.35	0.00	4,631.28
		XI	4,590.60	218.60	4,372.00	218.60	519.95	3,633.45	0.00	40.68
Total	54,673.76	12 MESECI	54,633.08	1,732.88	34,657.50	1,732.88	3,023.81	29,900.82	0.00	40.68

GRANT 10

Opstina 65510

Izvor fin.

Robe I usluge

Ekonomski kod 013200

Alocirani fond		CPO - Komunalne usluge					Br. CPO-a	Bilans (Saldo)	Opomena
Datum	Suma	Opis	Datum	Obaveza	Troseno	Ek. Kod			
	300	Poslovni rucak			209	14310	23070150		
	300	Kancelarijski materijal			307.38	13610	23070152		
	300	Servis komp			20	14040	23070153		
	600	Poslovni rucak			95.75	14310	23070224		
		Poslovni rucak			46.5	14310	23070225		
		Poslovni rucak			483	14310	23070226		
		Poslovni rucak		68.97	269.40	14310	23070301		
Total:	1,500.00			68.97	1,431.03			0.00	

1,431.03

GRANT

KANCELARIJA NACELNIKA

Izvor finansiranja10

Plata I ostalo

ekonomki Kod 011000

Alocirani fond		Troskovi plate I ostalo								Bilanci (Saldo) 2-4+10	Data Zotimit/Pagesës
Datum	Suma	za Mesec	Iznos 5+6	Taksa në pens. Punëdhënës i	Bruto plata	Taksa në pens. Punëmarrës i	Porez	Neto plata 6-7-8	Të kthyer		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12	
	1,652.00	1	750.75	35.75	715.00	35.75	17.97	661.28	0.00	901.25	
